

D-4.8.9.10.11.12.13
Të futet në rendet
e dështuar
17.12.18



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE

Nr. _____ prot.

Tiranë më _____ 2018

**Lënda: PROPOZIM KANDIDATURASH PËR ZGJEDHJEN E TRE ANËTARËVE
TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË**

**Drejtuar: Zotit Gramoz RUÇI
KRYETAR I KUVENDIT**

Këtu

I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Banka e Shqipërisë është institucion kushtetues dhe një nga organet drejtuese të saj është Këshilli Mbikëqyrës. Që nga 3.11.2018 në këtë Këshill janë krijuar tre vende vakant, të cilët, bazuar në nenin 44 të ligjit organik, nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar propozohen nga Kuvendi i Shqipërisë.

Në zbatim të ligjit nr. 8269, dt.23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 44 i tij, si dhe në mbështetje të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, Kuvendi i Shqipërisë publikoi në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë më datë 30.10.2014 njoftimin zyrtar, bazuar në Vendimin nr. 103/2018, dt. 4.10.2018 “Për procedurën paraprake të përzgjedhjes së tre anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë”, për plotësimin e tre vendeve vakante për anëtar të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, që propozohen dhe zgjidhen nga Kuvendi.

Kuvendi zhvilloi në proces të hapur, gjithpërfshirës dhe transparent, duke ftuar çdo individ që plotësonte kriteret ligjore që të kandidonte për tre vendet vakante të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Kuvendi kreu verifikimin e dokumentacionit ligjor për plotësimin e kërkesave të ligjit nga pesëmdhjetë kandidatët e vetofruar. Më datë 31.10.2018 u zhvillua seanca dëgjimore publike nga

Kuvendi, me secilin kandidat të vetofruar, ku prezent ishin anëtarët e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave. Kandidatët bënë prezantimin e përvojës së tyre dhe nga anëtarët e komisionit iu drejtuan pyetje lidhur me vizionin e tyre për pozicionin që kandidonin.

Mbi bazën seancës dëgjimore publike të zhvilluar, ne, një grup prej 28 deputetësh, pasi u njohëm me përvojën profesionale, meritën e kandidatëve dhe vizionin e tyre, i propozojmë Kuvendit të Shqipërisë për t'u zgjedhur anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë të propozuar nga Kuvendi kandidaturat e mëposhtme:

1. Artan Hoxha
2. Arben Malaj
3. Luljeta Minxhozi

Ligji organik, nr. 8269, dt.23.12.1997, “ Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në **nenin 44**, pika 2, parashikon se:

“Të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës zgjidhen dhe emërohen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, mbështetur në propozimet e bëra si më poshtë:

- *pesë anëtarë propozohen nga Kuvendi;*
- *tre anëtarë propozohen nga Këshilli i Ministrave;*
- *një anëtar propozohet nga Këshilli Mbikëqyrës”.*

*Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për anëtar të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë janë të parashikuara në **nenin 44, pika 3** si më poshtë:*

“Kandidatët për anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës duhet të jenë shtetas të Republikës së Shqipërisë, persona që gëzojnë ndershmërinë dhe pastërtinë morale, si dhe kanë:

- a) arsimin e lartë ekonomik ose juridik;*
- b) përvojë profesionale në çështje financiare dhe bankare;*
- c) kualifikime profesionale të profilit;*
- ç) përvojë pune mbi pesë vjet në administratën publike ose në institucionet financiare dhe bankare;*
- d) të mos kenë pengesa të parashikura në nenin 47”.*

Neni 47 parashikon se:

“Çdo anëtar i Këshillit Mbikëqyrës, duke përfshirë guvernatorin dhe zëvendësguvernatorët pezullohet nga detyra nga Këshilli i Ministrave dhe shkarkohet nga Kuvendi, në qoftë se ai ose ajo:

- a) është në pamundësi për të shërbyer në Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, sipas nenit 46;*
- b) është dënuar nga gjykata për një vepër penale, për të cilën ligji parashikon dënimin me burgim;*

c) është në pamundësi për të paguar detyrimet monetare ose është deklaruar i falimentuar dhe nuk është rehabilituar;

ç) është ndaluar ose pezulluar nga gjykata të ushtrojë detyrën si nëpunës shtetëror apo në shërbimin publik ose të ushtrojë veprimtarinë apo mjeshtërinë;

d) gjatë ushtrimit të detyrës, në mënyrë aktive merr pjesë në veprimtari politike.

Rastet e papajtueshmërisë me funksionin e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës parashikohen në **nenin 46** të ligjit si më poshtë:

“Funksioni i anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës është i papajtueshëm me atë të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, të deputetit në Kuvendin Popullor apo të anëtarit të Këshillit të Ministrave.

Funksioni i anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës është i papajtueshëm me atë të punonjësit, administratorit dhe aksionerit, me pjesëmarrje influencuese në bankën e nivelit të dytë apo në subjekte që licensohen nga Banka e Shqipërisë”.

Këto kritere, përputhshmëria e tyre me ligjin dhe rastet e papajtueshmërisë me funksionin e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës, janë vlerësuar paraprakisht edhe nga procesi i verifikimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar nga kandidatët, në bazë të vendimit të Kuvendit nr.83/2014 “Për procedurën paraprake të përzgjedhjes së tre anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë”.

Gjithashtu u vlerësua edhe merita profesionale gjatë performacës së tyre në dëgjuesën publike, të zhvilluar sipas procedurave parlamentare në Kuvendin e Shqipërisë.








Në vlerësojmë se kandidaturat e propozuara, me përvojën e tyre profesionale dhe akademike në fushën jurisprudencës, ekonomike/monetare bankare, si dhe me aftësitë e spikatura në ushtrim të profesionit, gëzojnë besimin e deputetëve dhe plotësojnë të gjitha kriteret ligjore për t’u zgjedhur anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Bashkëlidhur propozimit të grupit të 28 deputetëve është CV e tre kandidatëve dhe pëlqimi për kandidim.

**KRYETARI I GRUPIT PARLAMENTAR
TË PARTISË SOCIALISTE**

Taulant BALLA

GRUPI I DEPUTETËVE PROPOZUES:

1. Faubert Belle 
2. Enna Businatti 
3. Idir Begoy 
4. Kleudine Spina 
5. Jurgis Gyrbjo 
6. Andree Marts 
7. Thavit Buskap 
8. Charles Quai 
9. Pavin Astan 
10. Mus, Uzici 
11. Inay Horusha Inay 
12. Xuan Duzha Hoff 
13. Andrel Xhindi 
14. Akher Shamchi Hoff 

15. *Artemis defolio* *Artemis*
16. *Egmontia Gemeni* *Egmontia*
17. *Galap* *Sule* *Galap*
18. *Tetras* *Sho* *Tetras*
19. *Alia* *Volcanella* *Alia*
20. *Evis* *Tusli* *Evis*
21. *EDUARD* *SALR* *EDUARD*
22. *Ilma* *Salt* *Ilma*
23. *Ruby* *Kremer* *Ruby*
24. *Almis* *Kemballe* *Almis*
25. *Sporter* *Brooks* *Sporter*
26. *Bashlium* *Fino* *Bashlium*
27. *Alma* *Lochelt* *Alma*
28. *-Vullnet* *ling* *-Vullnet*
- 29.

30.

31.

32.

33.

34.

35.